

Deri te:

Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor - Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës nr. 13-1553/4 nga mbledhja e mbajtur më 27.12.2018, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull “Mandati parlamentar dhe ndërtimi i demokracisë – rasti i Kosovës”, të kandidatit LL.M. Zahir Çerkini, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Fatmire Lumani, Mentor; Prof. Dr. Mersim Maksuti, anëtar; Prof. Dr. Qebir Avziu, anëtar; Prof. Dr. Safet Emruli, anëtar; Prof. Dr. Enver Hasani, anëtar, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik i paraqet këtë:

RAPORT

për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

LL.M. Zahir Çerkini ka lindur në qytetin e Mitrovicës. Në atë qytet, ka kryer shkollën fillore dhe atë të mesme. Është diplomuar në juridik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” në vitin 2013 duke marr titullin jurist i diplomuar, dhe, po të njejtën vit ka regjistruar studimet master ku më 2014 ka diplomuar në drejtimin kushtetues-administrativ në po të njejtën institucion. Të dy nivelet e studimit i kreu me rezultat të lartë.

Përvoja e tij e punës është kryesisht akademike dhe profesionale, lidhur ngushtë me fushën e studimit. Në vitet 2014-2016 ishte ligjërues për të drejtat e njeriut në forume e OJQ të cilat merren me personat e pa-gjetur në Kosovë. Poashtu, hulumtues në disa projekte të OJQ-ve kosovare. Në vitin 2015, si pjesë e programit të Kombeve të Bashkuara UNDP, ai ishte angazhuar në Kuvendin e Kosovës në Komisionin për Legjislacion. Në po atë vit, ka filluar punën si ligjërues në Fakultetin Juridik të Universitetit të Mitrovicës “isa Boletini”, ku ende vazhdon të jetë.

Kontributi i deritanishëm shkencor i LL.M. Zahir Çerkini konsiston në këto punime të publikuara dhe konferenca:

- “President’s Veto and His Role in Parliamentary Republics: Case of Kosovo”, Revista: Acta Universitatis Danubius. Juridica, Print ISSN: 1844-8062 Online ISSN: 2065-3891, Rumani. Vol. 14, No. 2/2018;
- “Vlerat themelore që mbronë kushtetuta e Kosovës”, Revista “Juridica”, Botues: Kolegji Evropian “Juridica”, Prishtinë 2016/ Numër 5, Pranverë 2016;
- “Mbrojtja kushtetuese e lirive dhe të drejtave themelore në Gjykatën Kushtetuese”, Balkan Journal Of Interdisciplinary Research, Botues: International Institute For Private-, Commercial-, And Competition Law (Iipcl) Qershor 2015/ Nr.1, ISSN 2410-759X (print); ISSN 2411-9725 (online);
- “Sistemi gjyqësor shtyllë e rëndësishme e shtetit të së drejtës” REFORMA- Revistë Regjionale e Shkencave Shoqërore, Botues: ISLD-Instituti për Studime Ligjore dhe Demokratike 7 Mars 2015/ Nr. 1/2015, ISSN: 1800-9794, KDU 33/34 (05);
- “Kontrolli Parlamentar i punës së qeverisë-rasti i Kosovës”, CONSTITUTIO, Botues: Instituti për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare Prill 2014/ Nr. 3-4/2013, ISSN: 1409- 8962;
- “Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e demokracisë në Kosovë” ,Organizoi: Friedrich Ebert Stiftung –Prishtina Office, 2016.

Gjithashtu, ai ka botuar dhe disa shkrime në formë të opinionëve dhe vështrimeve në gazetë e shtypura dhe ato elektronike në Kosovë.

Disertacioni i doktoraturës me titull “Mandati parlamentar dhe ndërtimi i demokracisë – rasti i Kosovës”, i kandidatit LL.M. Zahir Çerkini, trajton ndikimin që ka parlamenti në demokratizimin e vendeve. Shtetet e reja të cilat tentojnë të ndërtojnë një demokraci të qëndrueshme, siç argumenton kandidati, kalojnë në disa procese dhe sfida jo të lehta. Këto sfida në masën më të madhe shfaqen në sistemin qeverisës, andaj, në sistemin parlamentar, sa më shumë demokraci që ka në parlament, në mënyrë zingjyrore do kemi demokratizim edhe të porcesëve tjera. Analiza mbi zgjedhjet, partitë politike, dhe sidomos ajo e mandatit dhe imunitetit parlamentar, pra, të ushtrimit të funksionit të përfaqësuesit të popullit, janë trajtimet kryesore të këtij disertacioni të doktoraturës.

Disertacioni me titull “Mandati parlamentar dhe ndërtimi i demokracisë - rasti i Kosovës”, na ofron pajme të qartë se të flasësh për ndërtimin e demokracisë në vendet në tranzicion, e sidomos

në vendet post-komuniste, pashmangshmërisht shpie deri tek trajtimi i institucionit qendror prej ku burojnë vlerat demokratike. Parlamenti, funksionet dhe kompetencat e tij, në vete sëndërtojnë parime të mëdha të demokracisë të cilat përbëjnë thelbin e një shteti të së drejtës. Ky punim, pa dyshim paraqet një këndvështrim ndryshe mbi pushtetin prej nga buron demokracia. Kandidati, ka arritur të paraqes faktin se, Kosova është përballur me një histori me shumë dallime në sisteme juridike, një reformë zgjedhore e nisur dhe e pa-përfunduar, një betejë politike mbi të drejtën e konstituimit të kuvendit, një interpretim nga Gjykata Kushtetuese mbi shtrirjen e imunitetit të zyrtarëve të lartë, një mandat parlamentar i shpërdoruar në emër të lirisë dhe demokracisë, dhe të gjitha këto, janë pikat mbi të cilat vendoset dilema se ky parlament që “është” a i kontribon me të vërtetë demokracisë, apo, duhet të vëmë në pah parlamentin “që duhet të jetë”. Andaj, disertacioni i kandidatit del të jetë mirë i fokusuar në rastin e Republikës së Kosovës, duke vënë në pah të gjitha dilemat përmes të cilave kalon procesi i demokratizimit të vendit.

Më tutje, disertacioni i kandidatit Çerkini, shpjegon se fazat tranzicionale të cilat përshkojnë shoqëri kryesisht të dala nga konflikte të armatosura ose situata të ndërrimit të formave të regjimeve politike, ka dëshmuar se demokracinë brenda tyre, mund ta kenë jo rrallë herë fiktive. Garimi nga ana e partive politike për pushtet, në vende në tranzicion, ka ditur të sjellë situata ku roli i përfaqësimit të qytetarit dhe interesave të tyre ka qenë në masë të madhe i papërfillshëm. Rrënimi i konceptit të përfaqësimit është në vete rrënim i vlerave të demokracisë. Andaj, vendosja e demokracisë në këto vende nisë pikërisht nga vet ideja dhe rregullimi i përfaqësimit. Si çdo vend tjetër me histori të njejtë, edhe në Kosovë, të pasurit një organ përfaqësues sa më demokratik dhe dinjitoz, garantohet në masë më të madhe vet demokracia. Përfaqësuesit e popullit, prezumohet se janë të aftë që t’i diskutojnë çështjet e atyre që i kanë zgjedhur, dhe kjo konsiderohet si një epërsi e tyre, dhe këtë mund ta bëjnë vetëm në parlament, si një organ i cili mendohet të jetë krijesa më e qëlluar e vënies në jetë të demokracisë përfaqësuese.

Gjatë trajtimit të temës, kandidati, ka arritur të dëshmoj cilësi të larta akademike në përdorimin dhe shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore. Kështu, vërehtë qartë se konstatimet e tij janë të bazuara në teoritë më të qëndrueshme dhe pranuar në botën e sotme. Sintetizimi i teorive

juridike dhe mendimeve juridike të autorëve të ndryshëm, spikatë në ndërtimin e argumenteve për të mbështetur tezat e punimit si dhe, për të artikuluar qartë idetë e thëna.

Metodologjia e zgjedhur për këtë disertacion, dhe, mënyra e përdorimit të saj, është vlerë e shtuar e kësaj pune kërkimore shkencore. Gërshëtimi i shkëlqyer i metodave si ajo analitike, krahasuese, deduktive, induktive, deskriptive, sintetike dhe hisotrike, e ka bërë të qartë, kuptueshëm dhe të rrjedhëshëm të gjithë tekstin. Përdorimi i metodave, dikund në mënyrë komulative, e në pjesë të veçanta, si të ndara, kanë shërbyer mjaftë mirë për t'i bërë bindëse argumentet e paraqitura në disertacion.

Disertacioni i kandidatit LL.M. Zahir Çerkini është i ndarë në pesë kapituj kryesorë, pjesën hyrëse dhe përfundimin.

Idetë filozofike dhe evolucioni historik, shënojnë pikënsijen e trajtimit të çështjes në kapitullin e parë. Në këtë pjesë të temës, argumentohen se cilat ishin idetë që shtyen në përhapjen e parlamentarizmit, çka është demokracia, modelet e saj dhe sfidat nëpër të cilat është duke kaluar ajo. Procesi i hartimit të kushtetutave dhe parlamenti nën parimin e ndarjes së pushteteve, gjithashtu, trajtohen këtu. Kuptimi i parlamentit, karakteristikat e tij dhe evolucioni historik, parë nën dritën e debateve teorike në kohë të ndryshme, përbëjnë tjetër pjesë të trajtimit në këtë kapitull.

Kapitulli i dytë trajton procesin përmes të cilit vihet deri tek konstituimi i parlamentit. Zgjedhjet si proces demokratik dhe partitë politike si akterë të jetës parlamentare. Këtu analizohen sistemet zgjedhore, e drejta e votës dhe teoritë rreth saj, kuptimi teorik i partive politike, karakteristikat e tyre, përcaktimi ideologjik i partive politike dhe kontrolli kushtetues i tyre. Gjithashtu, në këtë kapitull është analizuar edhe procesi zgjedhor në Kosovë, duke paraqitur një analizë mbi legjislacionin aktual që rregullon këtë fushë si dhe një çasje kritike mbi atë se a duhet të reformohet apo jo ky sistem. Partitë politike kosovare, janë tjetër pikë e fokusuar e këtij kapitulli, të cilat janë analizuar në rrafshin juridik dhe të përcaktimit ideologjik të tyre.

Në kapitullin e tretë është argumentuar se historia e parlamentit në Kosovë është një rrugë e përbashkët me ndërtimin e shtetit dhe vet demokracisë, andaj, trajtimi historik i strumbullarit të demokracisë dhe analiza kushtetuese dhe praktike e parlamentit të sotëm, kanë qenë të domosdoshme për të kuptuar saktë procesin e demokratizimit. Historia e re kushtetuese e

Kosovës ka marrë një hapsirë më të madhe të trajtimit në këtë kapitull, sidomos aspektet kushtetuese që përcaktojnë parlamentin dhe sistemin parlamentar, me të gjitha karakteristikat dhe sfidat nëpër të cilat ka kaluar ai.

Mandati parlamentar, si temë rreth së cilës mblidhet i gjithë punimi, përbën kapitullin e katërt. Këtu është pasqyruar qartë kuptimi teorik i mandatit, modelet e tij, mandati i parlamentit dhe mandati i deputetit, ushtrimi i funksioneve të deputetit dhe përballja e tyre me ekzekutivin. Gjithashtu, është analizuar në vështrim kushtetues çështja e konstituimit të kuvendit dhe sfidat nëpër të cilat ky proces ka kaluar në Kosovë. Aspektin kosovar të çështjes, në këtë kapitull e gjejmë në çdo trajtim, pas përplasjes së teorive të ndryshme. Analiza për Kosovën në këtë kapitull është mbështetur në normat kushtetuese dhe ligjore si dhe, nga vet praktika që ka krijuar ky shtet, respektivisht, nga puna e Kuvendit si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Më tutje në këtë kapitull argumentohet se pse Republika e Kosovës ka zgjedhur rrugën që deputetët e saj të mos i nënshtrohen asnjë mandati detyrues, duke e lënë deputetin të lirë për të vendosur mbi bindjet e tij. Detyrimi i vetëm i deputetëve është që atë mandat ta ushtroj në pajtim me kushtetutën. Në zhvillimin e demokracisë ka rol të pazëvendësueshëm mënyra e ushtrimit të mandatit të deputetit. Në vendet demokratikisht të pazhvilluara, mandati i parlamentit, ndonëse de jure, është i lirë, në fakt ushtrohet gjithmonë me një lloj rezerve, sidomos nga ana e shumicës parlamentare, kur kjo shumicë korrespondon me partinë ose koalicionin qeverisës. Ndodhë kështu, ngase ekziston një “frikë” nga ana e deputetëve që lideri i partisë, në rast se deputetët nuk mbështesin iniciativat e tij, mund të mos përfshij individin e tillë në planet e tij zgjedhore, për të ardhmen. Kjo, mund të sanohet duke emancipuar sa më shumë politikanët në vetëm një drejtim: respektimin dhe mbrojtjen e kushtetutës.

Kapitulli i fundit, ai i pestë, trajton çështjen e imunitetit parlamentar si një komponentë e rëndësishme e ushtrimit të funksionit të deputetit. Këtu argumentohet çështja se anëtarëve të parlamentit u është dhënë një shkallë e mbrojtjes kundër rregullave ligjore, civile apo penale, që në çdo rast tjetër zbatohen për të gjithë qytetarët. Kjo, për shkakun që përfaqësuesit e zgjedhur të popullit kanë nevojë për garanci të caktuara në mënyrë që të përmbushin në mënyrë efektive mandatin e tyre demokratik, pa frikën e akuzave nga gjykatat, të shtyra nga ekzekutivi ose kundërshtarët politik. Pra, imuniteti paraqet mbrojtjen të deputetit ndaj përgjegjësisë ligjore, nga çdo lloj i ndjekjes penale, padive civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e marra,

fjalimet e mbajtura, mendimet e shprehura, votat e dhënë e të ngjashme, brenda fushëveprimit të tij si deputet. Kandidati ka trajtuar në këtë kapitull teoritë mbi imunitetin parlamentar, modelet e tij, përfshirjen e tij, praktikën e Gjykatës Kushtetuese në Kosovë për imunitetin parlamentar, duke përfshirë edhe analizë krahasuese me vendet tjera. Gjithashtu, vend të rëndësishëm në këtë kapitull ka gjetur edhe aspekti i të drejtave të njeriut dhe imunitetit parlamentar.

Si pjesë tjera përbërëse të këtij disertacioni, hyrja dhe përfundimi, kanë arritur të shpërfaqin në mënyrën më të mirë, në radhë të parë: ofrimin e pamjes së qartë se çka ofron punimi dhe si është bërë trajtimi i temave në të. Dhe, në pjesën e përfundimeve janë nxjerrur konstatimet dhe rekomandimet të cilat do mund ta bënin më demokratik parlamentin dhe kësisoj të shtyhet tutje procesi i vendosjes së demokracisë në Kosovë.

Përfundimi dhe Propozimi

Disertacioni i doktoraturës me titull “Mandati parlamentar dhe ndërtimi i demokracisë – rasti i Kosovës”, i kandidatit LL.M. Zahir Çerkini, është vlerë e shtuar në punën kërkimore shkencore nga fusha juridiko - kushtetuese. Në këtë punim është analizuar mjaftë qartë roli që ka parlamenti dhe ushtrimi i mandatit parlamentar në demokratizimin e një vendi. Përdorimi i metodave adekuate, kanë bërë të mundur që të argumentohen të gjitha tezat e ngritura nga kandidati dhe të arrihet në përfundimet e sakta.

Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull “Mandati parlamentar dhe ndërtimi i demokracisë – rasti i Kosovës”, të kandidatit LL.M. Zahir Çerkini, konstaton se ky disertacion i doktoraturës i plotëson të gjitha kriteret shkencore të përcaktuara dhe i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës që të aprovoj këtë raport dhe të lejoj mbrojtjen publike.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Fatmire Lumani, Mentor _____
2. Prof. Dr. Mersim Masuti, anëtar _____
3. Prof. Dr. Qebir Avziu, anëtar _____
4. Prof. Dr. Safet Emeruli, anëtar _____
5. Prof. Dr. Enver Hasani, anëtar _____

